

VENDIM
Nr. 20, datë 19.1.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT
TË GAZIT NATYROR, NGA SHOQËRIA ALBGAZ SHA, PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të neneve 13, pika 2; 17, pika 1, germa “e”, dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; si dhe nenit 19 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve në lidhje me miratimin e tarifës së shoqërisë Albgaz sh.a., si operator i transmetimit të gazit natyror, për vitin 2018,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 85/1 prot., datë 3.1.2018 (protokolluar në ERE me nr. 13 prot., datë 4.1.2018), Albgaz sh.a., ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, ka certifikuar shoqërinë operatori i kombinuar i gazit natyror, Albgaz sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017, ka licencuar shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- Me vendimin, nr. 90, datë 7.6.2017, bordi i ERE-s ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017.

- Me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017, të bordit të ERE-s është vendosur mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017”, deri më 31.12.2017.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 14, datë 10.1.2018, është vendosur për shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit për shoqërinë Albgaz sh.a., miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, deri në datën 31.3.2018.

- Nuk është respektuar afati i aplikimit në zbatim të nenit 21, pika 3 të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, të bordit të ERE-s.

- Aplikimi duhet të shoqërohet me analiza dhe argumente për të gjitha shpenzimet operative të vitit ushtrimor të mbyllur, duke dërguar në ERE pasqyrat financiare paraprake për vitin 2017.

- Mungojnë argumentet dhe analiza e detajuara mbi nivelin e propozuar për të gjitha elementet përbërëse të kostove operative, konform nenit 7 dhe nenit 8 të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, për periudhën e ardhshme 2018.

- Aplikimi duhet të plotësohet me analizat e llogaritjeve të bazës së rregulluar të aseteve (RAB), për vitin 2017, për të evidentuar dhe për të paraqitur në këtë mënyrë gjendjen dhe lëvizjet e aseteve të krahasuara me pasqyrat financiare përkatëse.

- Shoqëria ende nuk ka paraqitur planin e investimeve për vitin 2018, me qëllim llogaritjen e RAB-së.

- Duhet të paraqiten në mënyrë analitike, të grupuara, llogaritjet e amortizimit për vitin 2017.

- Shoqëria nuk ka propozuar një normë të kthimit mbi kapitalin (WACC), në zbatim të formulës për llogaritje të nenit 10 të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”, por paraqet një vlerë fikse të këtij elementi të të ardhurave të kërkuara.

- Aplikimi nuk paraqet një vlerësim mbi konkurrueshmërinë e çmimeve të gazit për klientët fundorë.

- Për mungesën e dokumentacionit dhe të dhënave që kanë të bëjnë me parashikimet e

“Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, të bordit të ERE-s, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për vitin 2018.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë shoqërinë Albgaz sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti